



RREGULLORJA NR. 2001/28

MBI TË DREJTAT E PERSONAVE TË ARRESTUAR NGA ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor të vitit 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh, ndër të tjera, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, Pakon e Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Çfarëdo Forme të Arrestimit apo Paraburgimit dhe Rregullat Minimale të Standardeve për Trajtimin e të Burgosurve,

Me qëllim të vendosjes dhe të mbrojtjes së të drejtave të personave të arrestuar nga organet e zbatimit të ligjit,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

(a) “Person i arrestuar” do të thotë personi i cili është marrë në paraburgim nga organet e zbatimit të ligjit në pajtim me nenet 195 dhe 196 të Ligjit mbi procedurën penal në fuqi.

(b) “Organ i zbatimit të ligjit” do të thotë policia civile e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur po ashtu si Policia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara ose Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

Neni 2
Të drejtat e personit të arrestuar

2.1 Personi i arrestuar ka të drejtat e mëposhtme:

- (a) të informohet për arsyet e arrestimit në gjuhën në të cilën ai ose ajo e kupton;
- (b) të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, pos të jep të dhëna mbi identitetin e tij a të saj;
- (c) t'i jepet ndihma papagesë e përkthimit nëse ai ose ajo nuk mund ta kuptojë ose të flasë gjuhën e organeve të zbatimit të ligjit;
- (ç) t'i ofrohet ndihma e mbrojtjes sipas zgjedhjes së tij a të saj dhe të ketë mbrojtje nëse ai ose ajo nuk është në gjendje të paguajë për ndihmën ligjore;
- (d) t'i njoftojë ose të kërkojë nga organet e zbatimit të ligjit që ta njoftojnë anëtarin e familjes për arrestimin e tij apo ndonjë person tjetër të caktuar të cilin ai ose ajo e zgjedh;
- (dh) nëse është shtetas i huaj, ka të drejtë të komunikojë me gojë ose me shkrim përmes zyrës së ndërlidhjes, postës konsulare, misionit diplomatik të shtetit, qytetar i të cilit është ai ose ajo apo me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare, nëse ai ose ajo janë refugjatë ose janë nën mbrojtjen e një organizate ndërqeveritare dhe
- (e) t'i mundësohet vizita mjekësore ose trajtimi mjekësor.

2.2 Personi i arrestuar duhet të informohet:

- (a) me gojë për të drejtat e parashtruara në nenin 2.1(b) - (f) menjëherë pas arrestimit dhe
- (b) me shkrim për të drejtat e parashtruara në këtë Rregullore. Organet e zbatimit të ligjit ia lënë në dispozicion formularin e njoftimit me shkrim mbi të drejtat që i takojnë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

2.3 Çdoherë që një person i arrestuar intervistohet, ai ose ajo së pari duhet të informohet për të drejtën e tij për të heshtur, siç është parashtruar në nenin 2.1(b) dhe për të marrë ndihmën e mbrojtjes, siç është parashtruar në nenin 2.1(d).

Neni 3
E drejta për ndihmën e avokatit mbrojtës

3.1 Personi i arrestuar ka të drejtë për ndihmën e avokatit sipas zgjedhjes së tij a të saj.

3.2 Nëse personi i arrestuar nuk është në gjendje të paguajë ndihmën e avokatit mbrojtës, atij ose asaj duhet t'i sigurohet mbrojtja, në pajtim me procedurat e parashtruara në një urdhëresë administrative.

3.3 Personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mirëbesim me mbrojtjen me gojë dhe me shkrim. Komunikimet ndërmjet personit të arrestuar dhe mbrojtjes së tij a të saj mund të shihen, por jo të dëgjohen nga organet e zbatimit të ligjit.

3.4 Personi i arrestuar ka të drejtë që mbrojtësi i tij të jetë prezent gjatë tërë intervistave të organeve të zbatimit të ligjit. Nëse mbrojtja nuk paraqitet brenda dy orësh pas informimit për arrestimin, organet e zbatimit të ligjit duhet të marrin masa për zëvendësimin e mbrojtjes për personin e arrestuar. Së këndejmi, nëse zëvendësimi i mbrojtjes nuk paraqitet brenda një ore pas kontaktimit me organet e zbatimit të ligjit, personi i arrestuar mund të intervistohet vetëm nëse organet e zbatimit të ligjit vendosin se shtyerja e mëtejme do të dëmtonte seriozisht zhvillimin e hetimeve.

3.5 Pavarësisht nga neni 3.4, organet e zbatimit të ligjit në raste të veçanta mund ta intervistojnë personin e arrestuar para se të ketë ardhur mbrojtësi i tij, nëse ekzistojnë baza të arsyeshme për të konkluduar se informacioni i marrë nga personi i arrestuar mund të ndihmojë shpëtimin e jetës së një personit tjetër. Një intervistë e tillë mund të bëhet vetëm me qëllim të marrjes së atij informacioni. Madje edhe në rastet e tilla, të drejtat e personit të arrestuar sipas nenit 2.3 nuk mund të paragjykoen dhe, me rastin e ardhjes, avokatit duhet menjëherë t'i mundësohet që ta vizitojë personin e arrestuar.

3.6 Mund të hiqet dorë nga e drejta për ndihmën e mbrojtësit, nëse një gjë e tillë është bërë në mënyrë vullnetare dhe të informuar. Nëse personi i arrestuar ka hequr dorë nga një e drejtë e tillë, po pastaj kërkon përsëri ndihmën e mbrojtësit, ai ose ajo menjëherë mund ta gëzojë këtë të drejtë. Personat nën moshën 18-vjeçare mund të heqin dorë nga e drejta e ndihmës së mbrojtësit me pajtimin e prindit, kujdestarit ose të një përfaqësuesi të Qendrës për Punë Sociale, përveç në rastet e dhunës familjare ku janë përfshirë prindi ose kujdestari, atëherë prindi a kujdestari i tillë mund të mos e miratojë heqjen e të drejtës së tillë. Personat të cilët shfaqin shenja të sëmundjes mendore nuk mund të heqin dorë nga të drejtat e tyre për ndihmën e mbrojtësit.

3.7 E drejta për ndihmën e avokatit mbrojtës në pajtim me këtë nen mund të shtyhet deri në 24 orë nga koha e arrestit kur personi i arrestuar dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar dhe prokurori apo gjykatësi kompetent hetues konstaton se shtyerja kërkohet për shkak të nevojave të jashtëzakonshme për hetimin e rastit në fjalë. Prokurori ose gjykatësi kompetent hetues, para skadimit të periudhës së parë të shtyerjes prej 24 orëve, mund të vendosë se një shtyerje plotësuese prej 24 orësh është e nevojshme për shkak të nevojave të jashtëzakonshme për hetimin e rastit.

Neni 4

E drejta për njoftimin e familjes apo të personave të tjerë të duhur

4.1 Personi i arrestuar ka të drejtë t'i njoftojë apo të kërkojë nga organet e zbatimit të ligjit që ta njoftojnë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër të caktuar sipas zgjedhjes së tij a të saj lidhur me arrestimin e tij dhe vendin e paraburgosjes menjëherë pas arrestimit, por edhe me çdo ndryshim të mëpastajmë për vendin e burgosjes menjëherë pas ndërrimit të vendit të burgosjes kanë mundësi ta bëjnë një gjë të tillë.

4.2 Kur personi i arrestuar është nën moshën 18-vjeçare organet e zbatimit të ligjit duhet t'i njoftojnë prindërit ose kujdestarin e personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e paraburgosjes menjëherë pas arrestimit dhe me ndryshimet e mëpasme të vendit të burgosjes menjëherë pas ndërrimit të vendit të burgosjes. Nëse një njoftim i tillë është i pamundshëm ose do të ishte i dëmshëm për interesat e personit të arrestuar dhe nëse shprehimisht është refuzuar nga personi i

arrestuar, organet e zbatimit të ligjit menjëherë pas arrestimit duhet ta njoftojnë Qendrën për Punë Sociale.

4.3 Kur personi i arrestuar shfaq shenja të sëmundjes mendore, organet e zbatimit të ligjit duhet ta njoftojnë personin e caktuar nga ana e personit të arrestuar si dhe Qendrën për Punë Sociale lidhur me arrestimin dhe vendin e burgosjes menjëherë pas arrestimit dhe për çdo ndryshim pasues për vendin e burgosjes duhet ta njoftojnë menjëherë pas ndryshimit të vendit të paraburgosjes.

4.4 Kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, organet e zbatimit të ligjit po ashtu duhet menjëherë ta informojnë atë për të drejtën e komunikimit me gojë dhe me shkrim me zyrën e ndërlidhjes, me postën konsulare, me misionin diplomatik të shtetit qytetar i të cilit është ai ose përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare kompetente, nëse ai apo ajo është refugjat e në të kundërtën ai ose ajo është nën mbrojtjen e një organizate ndërkombëtare.

4.5 Njoftimi i anëtarit të familjes apo të personit të duhur në pajtim me nenet 4.1 dhe 4.2 mund të shtyhet deri në 24 orë nga koha e arrestimit kur prokurori ose gjykatësi kompetent hetues konstaton se shtyerja kërkohet për shkak të nevojave të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Megjithkëtë, në një rast të tillë kur personi i arrestuar është nën moshën 18-vjeçare njoftimi duhet të bëhet menjëherë pas arrestimit në Qendrën për Punë Sociale.

Neni 5

E drejta për kontrollim dhe trajtim mjekësor

5.1 Personi i arrestuar ka të drejtë, pas kërkesës së bërë, të kontrollohet nga një mjek të cilin e caktojnë organet e zbatimit të ligjit sa më shpejtë që të jetë e mundur pas arrestimit të tij a të saj.

5.2 Personi i arrestuar ka të drejtë po ashtu për trajtim mjekësor kurdo që është e nevojshme, pas kërkesës së bërë nga personi i arrestuar apo anëtari i familjes. Personit të arrestuar duhet t'i lejohet vizita dhe trajtimi mjekësor nga mjeku apo dentisti i tij, nëse organet e zbatimit të ligjit vendosin se ka baza për një kërkesë të tillë dhe se ai apo ajo është në gjendje t'i paguajë të gjitha shpenzimet e bëra.

5.3 Organet e zbatimit të ligjit po ashtu mund të caktojnë çdo kohë një mjek për kontrollim mjekësor në rast të lëndimit fizik apo nevojave të tjera të qarta mjekësore. Në rast se personi i arrestuar refuzon t'i shtrohet kontrollimit mjekësor ose nuk pranon trajtimin mjekësor, mjeku merr vendimin përfundimtar për nevojën e një kontrolli apo trajtimi të tillë, pas vlerësimit të duhur të të drejtave të personit të arrestuar.

5.4 Nëse personi i arrestuar shfaq shenja të sëmundjes mendore, organet e zbatimit të ligjit menjëherë mund të urdhërojnë një kontrollim të psikiatri.

5.5 Rezultatet e çdo vizite mjekësore apo çdo trajtimi mjekësor të ndërmarrë në pajtim me këtë nen duhet të regjistrohen në mënyrën e duhur dhe të dhënat e tilla duhet t'i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtjes së tij apo të saj, por edhe prokurorisë dhe gjykatës.

Neni 6

Regjistrimi i arrestimit dhe intervista nga organet e zbatimit të ligjit

6.1 Organet e zbatimit të ligjit mbajnë shënime me shkrim për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me personin e arrestuar, duke përfshirë edhe:

- (a) arsyen e arrestimit;
- (b) kohën dhe vendin e arrestimit;
- (c) identitetin e personave zyrtarë të organeve përkatëse të zbatimit të ligjit;
- (ç) njoftimin me gojë dhe me shkrim për personin e arrestuar lidhur me të drejtat e tij a të saj, siç është parashtruar në nenin 2.2 të kësaj Rregulloreje;
- (d) vendin e paraburgimit;
- (dh) sigurimin e mbrojtjes, siç është parashtruar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, duke përfshirë edhe përpjekjet për të kontaktuar mbrojtjen apo zëvendësimin e caktuar sipas rastit;
- (e) njoftimin e familjes apo të personave të tjerë të caktuar ose çfarëdo shtyerje lidhur me njoftimin, siç është parashtruar në nenin 4 të kësaj Rregulloreje dhe
- (f) kryerjen e vizitës mjekësore a ofrimin e trajtimit mjekësor, siç është parashtruar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

6.2 Organet e zbatimit të ligjit duhet të mbajnë shënime me shkrim për çdo intervistë a bisedë me personin e arrestuar, duke përfshirë fillimin dhe përfundimin e kohës së bisedës me personin e arrestuar si dhe identitetin e personave zyrtarë të organeve të zbatimit të ligjit që kanë zhvilluar intervistat dhe çfarëdo personash të tjetër prezentë. Nëse mbrojtësi nuk është i pranishëm, kjo duhet të shënohet në mënyrën e duhur.

6.3 Të dhënat me shkrim të parashtruara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni duhet t'i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij a të saj, nëse ato kërkohen, në gjuhën të cilën personi i arrestuar e kupton, por ato mund t'i mbajnë edhe organet e zbatimit të ligjit dhe prokurori deri sa të merret një vendim dhe të jenë futur në dosje për të inicuar hetimin ose për të hequr dorë nga hetimi.

Neni 7 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 8 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me këtë.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 nëntor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm